

# KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

NË GJUHË TË KUPTUESHME PËR FËMIJËT



“Të drejtat” janë gjërat, që çdo fëmijë duhet t’i posedojë ose të mund t’i realizojë. Të gjithë fëmijët kanë të drejta të njëjta. Ato të drejta janë theksuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Këta të drejta janë të ndërlidhura mes vete dhe janë njësoj të rëndësishme. Gjithnjë kur flasim për të drejtat e fëmijës, duhet të mendojmë në lidhje me atë që është më e mirë për fëmijët në një situatë të dhënë, gjegjësisht çka është kyçe për jetën e tyre dhe si të mbrohen ata, me qëllim që të mos lëndohen. Ashtu siç rriteni, do të fitoni përgjegjësi dhe mundësi më të madhe për të bërë zgjedhje personale dhe për t’i realizuar të drejtat tuaja.

“Konventa paraqet marrëveshje ndërmjet vendeve të ndryshme për respektim të kornizës së njëjtë ligjore. Shteti juaj e ka ratifikuar Konventën për të drejtat e fëmijës më 26 janar të vitit 1990 (në kuadër të ish Jugosllavisë) dhe më 2 dhjetor të vitit 1993 (kur u bë shtet i pavarur). Kjo do të thotë se shteti juaj duhet të përkujdeset, që çdo fëmijë t’i gëzojë të drejtat e konventës.



### **Neni 1** – Kush i gëzon këta të drejta?

Secili person nën moshën 18 vjeçare është fëmijë dhe i gëzon këta të drejta.

### **Neni 2** – E drejta e mosdiskriminimit

Të gjithë fëmijët i gëzojnë këta të drejta pavarësisht se ku jetojnë, çka punojnë prindërit e tyre, cilën gjuhë e flasin, cili është religjioni i tyre, pavarësisht a janë djem ose vajza, cila është kultura e tyre, a kanë pengesa, a janë të pasur ose të varfër. Me asnjë fëmijë nuk duhet vepruar padrejtësisht për çfarëdo qoftë baze.

### **Neni 3** – Gjithçka duhet të jetë në interesin tënd më të mirë.

Të gjithë të rriturit duhet ta bëjnë atë që është më e mirë për ty. Kur njerëzit dhe institucionet marrin vendime, duhet të mendojnë se çfarë ndikimi kanë vendimet e tyre ndaj fëmijëve.

### **Neni 4** – E drejta e realizimit të së drejtave tua

Shteti ka përgjegjësi të sigurojë mbrojtje të tyre. Ai e ka patjetër t'i ndihmojë familjes tënde të krijojë kushte dhe mjedis, në të cilin do të mund të rritesh dhe ta realizosh potencialin tënd.

### **Neni 5** – E drejta për udhëzim nga familja yte

Familja yte është përgjegjëse të të ndihmojë të mësosh sesi t'i realizosh të drejtat tua dhe të sigurojë respektimin e të drejtave tua.

### **Neni 6** – E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë. Shteti duhet të bëjë gjithçka, që të gjithë fëmijët të mund të mbijetojnë dhe të zhvillohen.

### **Neni 7** – E drejta e emrit dhe e nënshtetësisë

Nga vetë lindja ke të drejtë të emrit dhe nëse është e mundshme duhet t'i njohësh prindërit dhe ata të përkujdesen për ty. Emri yt duhet të shënohet në librin amzë. Po ashtu ke të drejtë të shtetësisë (t'i takosh një shteti).



### **Neni 8** – E drejta e identitetit

Ke të drejtë të kesh identitetin tënd, nënshtetësinë, emrin dhe marrëdhënie familjare. Askush nuk guxon të të privojë nga kjo e drejtë. Po ashtu, duhet të posedosh dokument zyrtar – siç është certifikata e lindjes e më pas edhe letër njoftimi.

### **Neni 9** – E drejta për familje, e cila kujdeset për ty

Ke të drejtë të jetosh me prindër(it), përveç se në rastet, kur një gjë e tillë është e keqe për ty. Nëse prindërit tuaj janë të ndarë, ke të drejtë të mbash kontakte me dy prindërit, përveç nëse një gjë e tillë ju dëmton.

### **Neni 10** –E drejta të jesh përsëri me familjen tënde

Kur fëmijët dhe prindërit jetojnë në vende të ndryshme, duhet lejuar të lëvizni ndërmjet vendeve, ashtu që fëmijët dhe prindërit do të ngelin në kontakt ose përsëri do të mund të jetojnë bashkërisht si familje.

### **Neni 11** –E drejta e mbrojtjes nga kidnapimi

Ke të drejtë të mbrohesh, që të të mos nxjerrin ilegalisht nga vendi juaj, gjegjësisht të drejtë për mbrojtje, nëse përkundër vullnetit tuaj ju ndalojnë jashtë vendit.



**Neni 12** – E drejta për ta shprehur mendimin tënd

Ke të drejtë ta japësh, gjegjësisht ta shprehësh mendimin tënd, ndërsa të rriturit duhet të të dëgjojnë dhe me seriozitet ta pranojnë opinionin tënd. Kjo në veçanti vlen, kur duhet të merren vendime, të cilat kanë të bëjnë me ty.

**Neni 13** – E drejta të shprehesh në mënyra të ndryshme

Ke të drejtë zbulosh gjëra dhe të ndash mendimin tënd me të tjerët, përmes të folurit, vizatimit, shkrimit ose çfarëdo qoftë forme, përveç nëse një gjë e tillë nuk i shkel ose ofendon njerëzit tjerë.

**Neni 14** – E drejta e religjionit tënd

Ke të drejtë ta zgjedhësh religjionin ose besimin tënd. Prindërit e tu duhet të të

ndihmojnë, të vendosësh se çka është e mirë, çka është e keqe dhe çka është më e mirë për ty.

**Neni 15** – E drejta e bashkimit dhe tubimit paqësor

Ke të drejtë t'iu bashkëngjitësh ose të formosh grupe dhe së bashku me fëmijë dhe njerëz tjerë të rinj, t'i shprehësh qëndrimet tua, përderisa një gjë e tillë nuk i lëndon të tjerët.

**Neni 16** – E drejta e privatësisë

Ke të drejtë të privatësisë. Ke të drejtë të mbrohesh nga sulmet ndaj mënyrës se si jeton, sulmet ndaj familjes tënde ose gjërave, që të takojnë ty.



**Neni 17** – E drejta për informacionet, të cilat i kupton

Ke të drejtë të marrësh informacione, të cilat janë të rëndësishme për mirëqenien tënde edhe atë nga televizioni, librat, radioja, gazetat, kompjuterët dhe burime tjera.

Ke të drejtë të mbrohesh nga informacione dhe materiale të dëmshme për ty dhe udhëzime për t'i gjetur dhe kuptuar informacionet e nevojshme.

**Neni 18** – E drejta e kujdesit nga prindërit tuaj

Ke të drejtë të përkujdesjes së barabartë nga prindi yt/ prindërit tuaj. Nëse ka nevojë duhet ofruar ndihmë prindit/prindërve ose tutorit në lidhje me kujdesin për ty, edukimin dhe zhvillimin tend.

**Neni 19** – E drejta e mbrojtjes nga dhuna

Ke të drejtë për kujdes dhe mbrojtje adekuate nga lëndimi, keqtrajtimi fizik ose mendor , qoftë nga prindërit e tu ose nga kushdo tjetër.

**Neni 20** – E drejta e kujdesit në mjedisin familjar

Nëse ndonjë familje yte nuk mund të përkujdeset për ty, atëherë për ty duhet të përkujdeset familje ose ndonjë institucion tjetër, që e respekton religionin, kulturën dhe gjuhën tënde.

**Neni 21** – E drejta e kujdesit, nëse je i/e adoptuar

Ke të drejtë të kujdesit dhe mbrojtjes, nëse je i/e adoptuar ose strehuar në familje që ofron kujdes, ku gjithnjë do të përkujdesen për atë, që është më e mire për ty.

**Neni 22** – E drejta e mbrojtjes së posaçme, nëse je refugjat

Ke të drejtë të mbrojtjes së posaçme dhe ndihmës, nëse je refugjat (nëse ke qenë i/e detyruar ta braktisësh shtëpinë dhe të jetosh në shtet tjetër), si dhe i gëzon të gjitha drejtat e kësaj konvente.

**Neni 23** – E drejta e mbështetjes shtesë, nëse ke ndonjë paaftësi

Nëse ke pengesë, ke të drejtë për mbështetje shtesë, me qëllim që të mund të shkosh në shkollë, të mjekohesh dhe të zhvillohesh, që të kesh jetë të plotë dhe të pavarur. Ti i gëzon të gjitha të drejtat e kësaj konvente si dhe të drejtat e Konventës për personat me paaftësi.

**Neni 24** – E drejta e mbrojtjes më të mirë shëndetësore

Ke të drejtë për mbrojtje më të mirë shëndetësore, ujë të pijshëm, ushqim të mirë, mjedis të pastër dhe të sigurt si dhe informacione, të cilat do të të ndihmojnë të jesh në gjendje të mirë.



**Neni 25** – E drejta të kontrolloni se në çfarë kushte jeni të akomoduar/nëse nuk jetoni në shtëpi

Nëse gjendesh në ndonjë institucion ose nuk qëndron në shtëpi për shkak të rrethanave tjera, ke të drejtë për kontrollim të rregullt, nëse akomodimi jep efekt dhe përmirësohet gjendja, me qëllim që të verifikohet, nëse është akomodimi më adekuat dhe më i mirë për ty.

**Neni 26** – E drejta e ndihmës, nëse familja yte është e varfër

Ke të drejtë për mjete plotësuese financiare nga qeveria, nëse familja yte është e varfër ose ka nevojë për ato mjete

**Neni 27** – Kam të drejtë për standard të mirë jetësor

Ke të drejtë për ushqim, rroba, vend të sigurt për jetë dhe të drejtë të të përmbushen nevojat tua themelore.

Duhet të jetosh në kushte, të cilat do të mundësojnë, ta bësh shumicën e gjërave, që i bëjnë fëmijët tjerë.

### **Neni 28** – E drejta e arsimit të mirë

Ke të drejtë për arsim të mire, cilësor dhe falas. Duhet të të inkurajojnë që rregullisht të shkosh në mësim dhe të arsimohesh deri në nivelin më të lart, që mundesh. Shkolla yte duhet të jetë vend i sigurt, ku mbahet llogari për disiplinën përmes respektimit të dinjitetin tënd.

Shtetet e pasura duhet t’iu ndihmojnë shteteve të varfra, që fëmijët të shkojnë në shkollë dhe të zhvillohen teknika dhe metoda mësimore.

### **Neni 29** – E drejta e arsimit, e cila do të të ndihmojë t’i zhvillosh veçoritë dhe aftësitë tua më të mira

Arsimi duhet të të ndihmojë, t’i përdorësh dhe zhvillosh talentet dhe aftësitë tua. Po ashtu arsimi duhet të të ndihmojë të mësosh sesi të jetosh në paqe, ta ruash mjedisin jetësor, t’i respektosh prindërit dhe njerëzit tjerë, ta respektosh kulturën tënde dhe kulturën e të tjerëve.

### **Neni 30** – E drejta e mbrojtjes së kulturës tënde, kur dallohet nga kultura e më shumë njerëzve tjerë



Ke të drejtë t’i mësosh dhe përdorësh gjuhën dhe zakonet e familjes tënde, pavarësisht nëse i përdorin ato shumica e banorëve në vendin në të cilin jeton. Grupeve pakica dhe autoktonë duhet t’iu garantohet mbrojtje e posaçme e kësaj të drejte.

### **Neni 31** – E drejta e lojës dhe pushimit

Kam të drejtë për pushim, lojë dhe përfshirje në aktivitetet më të ndryshme.

### **Neni 32** – E drejta e mbrojtjes nga puna e rrezikshme, e cila të pengon nga shkuarja në shkollë

Nuk duhet të të lejojnë të bësh punë, të cilat mund të jenë të dëmshme për ty, të cilat janë të këqija për shëndetin tënd dhe për shkak të së cilave nuk mund të shkosh në shkollë. Nëse punon, ke të drejtë për kushte të sigurta për punë dhe të marrësh rrogë të duhur.

### **Neni 33** – E drejta për mbrojtje nga droga

Ke të drejtë të mbrohesh nga droga dhe biznesi i prodhimit dhe shitjes së drogës.



### **Neni 34** – E drejta e mbrojtjes nga abuzimi seksual

Ke të drejtë për mbrojtje nga abuzimi seksual. Askush nuk guxon të të prek ose të kërkohë nga ty të shfaqësh pjesë të trupit tënd të zhveshur. Askush nuk guxon të kërkohë nga ti, të prekësh ose të të shfaq pjesë të zhveshura të trupit. Të rriturit duhet të të mbrojnë nga njerëzit, të cilët në këtë mënyrë dëshirojnë të të shkaktojnë dëm.

### **Neni 35** – E drejta për mbrojtje nga kidnapimi dhe shitja

Askujt nuk i lejohet të të kidnapojë ose të të shesë. Qeveria duhet të bëjë gjithçka, që të pengojë të gjendesh në situatë të tillë, në të cilën ke rënë përkundër vullnetit tënd

### **Neni 36** – E drejta e mbrojtjes nga aktivitetet, të cilat mund t'i bëjnë dëm zhvillimit tënd

Ke të drejtë të mbrohesh nga çfarëdo qoftë lloji i eksploatimit (shfrytëzim tënd).

### **Neni 37** – E drejta e mbrojtjes nga mizoria dhe përbuzja në rast se e shkeli ligjin

Askujt nuk i lejohet të të dënojë në mënyrë mizore, me çka do të të përbuzë në rast se biesh ndesh me ligjin. Asnjëherë nuk duhet të të fusin në paraburgim së bashku me

persona të rritur dhe gjithnjë duhet të kesh kontakt me familjen tënde. Kur privohesh nga liria, ke të drejtë për ndihmë ose të parashtrosh pyetje. Gjykatësi ose organi tjetër duhet të merr vendim emergjent në lidhje me rastin tënd.

### **Neni 38** – E drejta e mbrojtjes në kohë luftë


Ke të drejtë për mbrojtje dhe liri gjatë gjendjes së luftës. Qeveria yte nuk duhet të lejojë, që fëmijët nën moshën 15 vjeçare të shkojnë në ushtri. Nëse gjendesh në zonë lufte, duhet të marrësh mbrojtje të posaçme.

### **Neni 39** – E drejta për ndihmë, nëse ndaj teje kanë vepruar keq

Ke të drejtë për ndihmë, nëse ke qenë i/e lënduar, neglizhuar ose keqtrajtuar.

### **Neni 40** – E drejta e ndihmës juridike dhe veprimit të drejtë gjatë ballafaqimit me ligjin

Nëse je i/e akuzuar për shkelje të ligjit, duhet të marrësh ndihmë juridike dhe trajtim të drejtë nga njerëzit, të cilët punojnë në sistemin e sundimit të ligjit dhe gjyqësisë.



Do të të dërgojnë në burg vetëm nëse vërtetohet se ke kryer vepër të rëndë penale. Çdoherë duhet të ndërmerren masa për përmirësim të sjelljes tënde edhe nëse është vërtetuar se ke kryer vepër të rëndë penale.

**Neni 41** – E drejta për mbrojtje më të mirë të të drejtave tua  
Nëse në vendin tënd ligjet sigurojnë

mbrojtje më të mirë të të drejtave tua, sesa nënenet e kësaj konvente, atëherë duhet të zbatohen ato ligje.

**Neni 42** –E drejta e njohjes së të drejtave tua

Ke të drejtë t'i njohësh të drejtat tua! Të rriturit duhet njashtu t'i njohin ato të drejta dhe të të ndihmojnë t'i mësosh ata.



**Nenet nga 43 deri në 54** – Konventa po ashtu shpjegon sesi do të punojnë qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtje të të drejtave tua.

Nenet nga 43 deri në 54 - Këta nene japin shpjegim për mënyrën sesi qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, siç është UNICEF-i do të punojnë, me qëllim që të sigurojnë, që ti dhe fëmijët tjerë të jeni të mbrojtur përmes të drejtave të lartpërmendura si dhe të drjetave të fëmijës.





[www.detskiprava.mk](http://www.detskiprava.mk)



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Magedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
**OMBUDSMAN**  
Republic of Macedonia

design: [www.koma.mk](http://www.koma.mk)